

Përfitimet nga të nxënit për të rriturit

Bashkohuni me komunitetin e EPALE me më shumë se 20 000 specialistë të të nxënit për të rritur për të vlerësuar, komentuar dhe kontribuar!

Të dashur kolegë të EPALE,



Në muajin shkurt EPALE i kushtoi vëmendje të veçantë **përfitimeve që rrjedhin nga të nxënit për të rriturit**. Gjatë kësaj kohe ekipet kombëtare të EPALE kanë publikuar artikuj të ndryshëm, studime dhe burime të tjera në lidhje me efektet pozitive të të nxënit për të rriturit tek vetë ata, tek shoqëria dhe ekonomia.

Postime në formë blogu

Përfitimet që rrjedhin nga të nxënit për të rriturit; ne dimë sesi të krijojmë "rrugë efektive për rritjen e aftësive"!

Koordinatori Tematik i EPALE, **Andrew McCoshan**, ka reflektuar në lidhje me mënyrën sesi sektori i të nxënit për të rriturit mund të ndihmojë për t'ju përgjigjur

thirrjes nga Këshilli i BE për të hapur rrugë zhvillimi për të rriturit me aftësi të dobëta bazë.

Duke folur për përfitimet që rrjedhin nga të nxënit për të rriturit

Dr. Sam Duncan nga Instituti i Arsimit i UCL ([linku është i jashtëm](#)) ka analizuar të tetë intervistat gjysëm të strukturuar me nxënës në moshë të rritur në Angli, të kryera si pjesë e projektit të BE-së *BeLL*.

Përfitimet nga të nxënit për të rriturit në moshën e katërt

Koordinatorja Tematike e EPALE, Gina Ebner, flet në lidhje me përfitimet shëndetësore që rrjedhin nga të nxënit për të rriturit për personat e moshuar.

Përse pyesim se çfarë mund të arrijë të nxënit për të rriturit?

Dhe ndërkohë që të gjithë po flisnin për përfitimet që rrjedhin nga të nxënit për të rriturit, [Simon Broek](#) ndau me ne një shqetësim për një çështje më themelore të cilën ne mund ta harrojmë.

Lajme nga mbarë Europa



Muaji shkurt ka qenë një muaj i ngjeshur me aktivitete përsa i përket sektorit të të nxënit për të rriturit në mbarë Europën:

- **Ministria e Kulturës e Baden-Württemberg (Drejtoria e Asimit të Vazhdueshëm) ka publikuar një manual të ri**, i hartuar për të ndihmuar trajnuesit që të përdorin mediat dixhitale në punën e tyre (në gjuhën gjermane).
- Ndërkohë në Estoni, Këshilli Profesional i Arsimit **ka miratuar standarde të reja profesionale në arsimin profesional për të rriturit** (në gjuhën estoneze).
- **Danimarka do të investojë 13 milion kron** (17.5 milion euro) për bibliotekat publike dhe qendrat arsimore për nisma të reja komunikimi (në gjuhën daneze).

Bashkohuni tani!

Mos harroni të regjistroheni në EPALE për të qenë në gjendje që të ndani mendimet tuaja në këto postime. **Bashkohuni tani** dhe bëhuni pjesë e komunitetit të përbërë nga më shumë se 20 000 specialistë të të nxënit për të rriturit.